



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:263911

Datë: 10.05.2023

Numri i dokumentit: 04264221

PKR.nr.4/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, Kryetari i Trupit Gjykes Sami Sharaxhiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Tringa Zhuti, në çështjen penale ndaj të pandehurit E. (R.) B., nga f. K., K. e K., me banim në rrugën “M. e K.”, .., i akuzuar për vepër penale *falsifikim i rezultateve të votimit* nga neni 216 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.66/2022, të datës 06.01.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 03.05.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Agron Galani, të pandehurit E.B. dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokatit Ahmet Rexhaj, të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa, me datë 10.05.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri :

E.B., i lindur me datë, në fshatin K., K. K., me banim në rrugën “M. e K.” .., i biri i R. dhe S., e gjinisë H., i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, student i FSHMN - së, i identifikuar sipas numrit personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me 06.10.2019, në Shkollën Filllore “A. B.”, në f. K., K. K., vendvotimi nr./...., në K., në zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme të organizuara me atë datë, në cilësinë e kryetarit të komisionit zgjedhor, regjistron në mënyrë të pasaktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore, në atë mënyrë që, në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK), regjistron njëqind e njëmbëdhjetë (111) vota më pak dhe nëntëdhjetë e shtatë (97) vota më shumë, gjithsej dyqind e tetë (208) vota të regjistruara pasaktë për kandidatë të ndryshëm brenda këtyre subjekteve të ndryshme politike, shifra këto që kanë rezultuar pas procesit të rinumërimit të votave për vendvotimin në fjalë, të përsëritur me datë 26.08.2022,

- me çka ka kryer vepër penale *falsifikimi i rezultateve të votimit*, nga neni 216 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 70, neni 216 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së si dhe nenet 358, 359, 360, 364 të KPPRK-së, të pandehurit E.B. i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit i përcaktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri brenda periudhës prej një (1) viti nuk kryen veprë të re penale.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzetepesë (25) euro si dhe në emër të taksës për kompensim të viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konform nenit 59 par.1.dhe.2 pika 1.23.të KPRK-së, të pandehurit i shqiptohet **DËNIMI PLOTËSUES** – heqja e të drejtës për tu zgjedhur në kohëzgjatje prej një (1) viti.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit Aktakuzën PP/I.nr.66/2022, të datës 06.01.2023, ndaj të pandehurit E. (R.) B., nga f. K., K. e K., me banim në rrugën “M. e K.”, ..., për veprë penale *falsifikim i rezultateve të votimit* nga neni 216 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata caktoj dhe mbajti seancën fillestare me datë 03.05.2023, në prezencën e prokurorit të shtetit Agron Galani, të pandehurit E.B. dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokatit Ahmet Rexhaj, nga Peja.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit PP/I.nr.66/2022, të datës 06.01.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe të njëjtit ia ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata e ka udhëzuar të pandehurin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë me ç’rast i pandehurit E.B. deklaroi se i kanë kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e gjykatës dhe se e pranon fajësinë në baza vullnetare, i pandikuar nga askush dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij, i njëjti ka deklaruar se i vie keq për rastin e ndodhur, është penduar thellë dhe i ka premtuar gjykatës që një rast i tillë nuk do të ndodhë në të ardhmen.

Prokurori e shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi ky pranim është i vullnetshëm dhe në harmoni me provat që gjenden në shkresat e lëndës, duke i propozuar gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të ketë parasysh si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë së të pandehurit, pendimin për veprën e kryer penale dhe mos dënueshmërinë e gjertanishme të tij gjithashtu, ka mbetur pranë propozimit për shqiptimin e dënimit plotësues konform nenit 59 par.1.dhe.2 pika 1.23.të KPRK-së – heqja e të drejtës për tu zgjedhur në afat prej një (1) viti.

Mbrojtësi i të pandehurit E.B., avokati Ahmet Rexhaj, deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij ngase pranimi është i vullnetshëm dhe paraprakisht janë konsultuar dhe ia ka treguar pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë gjithashtu, i ka propozuar gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të ketë parasysh rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë, gjendjen jo të mire ekonomike, pendimin dhe shprehjen e keqardhje lidhur me veprën e kryer, faktin se më parë ka qenë si kryesues i komisionit zgjedhor dhe lëshimet e konstatuara janë bërë pa dashjen e tij dreket dhe t'i shqiptohet një dënim më i butë konform dispozitave ligjore dhe praktikës gjyqësore për vepra të tilla.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hedhje të aktakuzës konform nenit 248 të KPPRK-së dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 241 dhe 242 par.2 pika 2.1 deri 2.4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave por, gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë, pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Libri i votimit, për vendvotimin nr./..., në K., Formulari i Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve, për vendvotimin nr./..., në K., Formulari i Rezultateve të Kandidatëve, për vendvotimin nr./..., në K., Formulari i Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve, për vendvotimin nr./..., në K., pas rinumërimit, Formulari i Rezultateve të Kandidatëve, për vendvotimin nr./..., në K., pas rinumërimit, Tabela me të dhëna specifike mbi diferencën e numrit të votave të kandidatëve, Raporti i hetuesit H. R. #..., i përpiluar nën nr. të rastit:-D-..., i datës 30.08.2022, Tabela me të dhëna specifike mbi diferencën e numrit të votave të kandidatëve, pas rinumërimit sipas kërkesës së Prokurorisë, Formulari i Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve për vendvotimin e njëjtë, pas rinumërimit të fletëvotimeve sipas kërkesës së Prokurorisë, Formulari i Rezultateve të Kandidatëve për vendvotimin e njëjtë, pas rinumërimit të fletëvotimeve sipas kërkesës së Prokurorisë, Deklarata e të dyshuarit E.B., e dhënë pranë DRP – Sektorit Rajonal të Hetimeve - Pejë, me datë 19.10.2022, Deklarata e të dyshuarit R. B., e dhënë pranë DRP – Sektorit Rajonal të Hetimeve - Pejë, me datë 19.10.2022, Deklarata e të dyshuarit R. B., e dhënë pranë DRP – Sektorit Rajonal të Hetimeve - Pejë, me datë 17.10.2022, Deklarata e të dyshuarit H. B., e dhënë pranë DRP – Sektorit Rajonal të Hetimeve - Pejë, me datë 17.10.2022, Deklarata e të dyshuarit F. P., e dhënë pranë DRP – Sektorit Rajonal të Hetimeve - Pejë, me datë 24.10.2022, si dhe shkresat tjera të lëndës, erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilën është shpallë fajtor.

Duke vendosur lidhur me vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese për të pandehurin gjeti se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur dhe është penduar, pati sjellje korrekte dhe gjykata nuk ka të dhëna se i njëjti më parë ka qenë i dënuar ndërkaq, nga rrethanat rënduese për të pandehurin gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së e obligoi të pandehurin në pagimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3 nënpar. 3.2 të Ligjit për Kompensim të Viktimave të Krimit e obligoi të pandehurin që të paguaj taksën për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.4/23, me datë 10.05.2023**

**Kryetari i Trupit Gjyqësor
Sami Sharaxhiu**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.